



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/75
Datë: 23.05.2012

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 14 të Ligjit, nr. 03/L-041 për Kufijtë Administrativ Komunal duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr.02/2011 për fushat e përgjegjesisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr.07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr.09/2011, Duke konsideruar krijimin e një mekanizmi të përkohshëm administrativ si një përgatitje të nevojshme për themelimin e komunës së re të Mitrovicës Veriore dhe duke theksuar se Komunës së Mitrovicës i janë dërguar njoftimet e nevojshme nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në përputhje me Kapitullin 10, nenin 74 të Ligjit Për Vetëqeverisjen Lokale, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 23 maj 2012, mori:

V E N D I M

Për themelimin e Zyrës Administrative të Mitrovicës Veriore

1. Themelohet Zyra Administrative e Mitrovicës Veriore (ZAMV), që do të udhëhiqet nga një Zyrtar Kryesor Ekzekutiv, me qëllim të ofrimit të shërbimeve për qytetarët e Mitrovicës Veriore, siç përcaktohet në Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale, dhe ashtu siç renditen në Koncept Dokumentin e bashkangjitur. Zyra Administrative e Mitrovicës Veriore do të ekzistojë deri në themelimin e Komunës së Mitrovicës Veriore, ose derisa të vendoset ndryshe nga Qeveria.
2. Zyra Administrative e Mitrovicës Veriore do të financohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe do të krijohet si një njësi e veçantë buxhetore, siç përcaktohet në Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë. Buxhetet që janë alokuar më parë për financimin e Administratës së Përkohshme të UNMIK-it në Mitrovicë do të transferohen në buxhetin e ZAMV.
3. Përveç tjerash, Qeveria do të alokojë drejtpërdrejt nga Buxheti Qendror i Kosovës deri në 1,000,000.00 € në këtë vit fiskal, për të mbështetur infrastrukturën e përgjithshme dhe sensibilizimin në Mitrovicën Veriore, që do të shpenzohen nëpërmjet ZAMV. Për të adresuar një mungesë të investimeve prej një dekade në infrastrukturë publike, një shumë ekuivalente do të alokohet për çdo vit në 5

vitet e ardhshme buxhetore për Mitrovicën Veriore, përmes ZAMV për aq kohë sa do të ekzistoj ose Komunës së Mitrovicës Veriore. Qeveria do të mbështes kërkesat shtesë për përkrahje financiare të bëra nga ZAMV sipas nevojës dhe realizueshmërisë.

4. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Ministria e Financave janë përgjegjëse për zbatimin e këtij vendimi, përderisa të gjitha ministritë tjera janë të obliguara t'i ofrojnë Zyrës Administrative të Mitrovicës Veriore mbështetjen e nevojshme në përputhje me fushat e tyre të përgjegjësisë. Përveç kësaj, Komuna e Mitrovicës do të jetë e obliguar të bëjë çdo dhe të gjitha transferet e nevojshme në Zyrën Administrative të Mitrovicës Veriore, apo të ndërmarr ndonjë masë tjetër të duhur, siç kërkohet nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në pajtueshmëri me nenin 74 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale.

5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë